



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevcı Nr.8 ♦ Prishtinë ♦ Kosovë Tel: ++381 38 500 400 0 Fax: ++ 381 38 248 076  
E-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org); [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) (në tekstin e mëtutjeshëm ("Agjencia"), duke u bazuar në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 (me ndryshime), nenin 68, të Ligjit, nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenin 10.3 të Politikave Operacionale të Agjencisë, publikon këtë:

### FTESË PËR APLIKIM ME QËLLIM TË HARTIMIT TË LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PUNËTORËVE

Të gjithë punëtorët të cilët konsiderojnë se i plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e një pjese të të hyrave prej 20% nga privatizimi/ likuidimi i NSh "Banka e Kosovës-BANKKOS" në Prishtinë (PRN132); Fi 99/78 si në vijim:

Për shkak të statusit të veçantë të të punësuarve në këtë NSh, e në mungesë të personave të zgjedhur nga organet përkatëse të NSH ,nuk është hartuar Lista e përkohshme e punëtorëve në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/13 (me ndryshime) dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi që e rregullojnë këtë fushë.

Me qëllim që të përfundojë procedura e pagesës të një pjese prej 20% nga çmimi i shitjes së NSh Banka e Kosoves-BANKKOS në Prishtinë, Agjencia në mungesë të Listës së përkohshme përkatëse publikon këtë njoftim me kërkesë që të gjithë punëtorët e kësaj NSh të plotësojnë formularin e bashkangjitur me poshtë dhe Agjencisë ti dërgojnë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me pikën 1 te formularit të bashkangjitur, në mënyrë që të shqyrtohet mundësia e realizimit të të drejtave të punëtorëve, në adresën e vendosur në fund të këtij njoftimi.

Emri i NSh-së	NSH Banka e Kosovës-BANKKOS në Prishtinë	
Emri i parashtruesit të ankesës		
<b>PROVAT TË CILAT I BASHKANGJITEN ANKESËS</b>		
1	Kopja e librezës së punës apo ndonjë dëshmi tjetër që konfirmon punësimin në NSh. Të gjitha kopjet e dokumentacionit duhet të jenë të vërtetuara nga organi kompetent.	Po/Jo
2	Adresa:	Po/Jo

	Nr. i tel:	
3	A konsideroni se jeni dëmtuar për shkak të diskriminimit	Po/Jo
4	Provat tjera shtesë lidhur me ankesën	Po/Jo
<b>Kundërshtimi i ndonjë emri/emrave të punëtorëve të cilët janë aktualisht në listë</b>		
5	Mbi cilën bazë kundërshtohet përfshirja e një apo më shumë emrave të punëtorëve në listë.	Po/Jo
6	Korrigjimi i përvojës së punës në listën e përkohshme	Po/Jo
<b>Nënshkrimi i parashtruesit të ankesës</b>		<b>Data</b>

Në rast se ankesa parashtrohet në emër të ushtruesit të ankesës nga pala e tretë (p.sh avokati), atëherë ai/ajo duhet të prezantojë autorizimin e vërtetuar me shkrim për të ndërmarrë veprime juridike në emrin e tij/saj.

**TË GJITHA KËRKESAT NË LIDHJE ME KËTË NJOFTIM DUHET TË DORËZOHEN NË AGJENCINË KOSOVARE TE PRIVATIZIMIT DERI MË DATËN 26.10.2013 PARA PËRFUNDIMIT TË ORARIT TË PUNËS**

Nëse është e nevojshme Agjencia, mund të kërkojë informata shtesë ose të mbajë seanca dëgjimore për t'i shqyrtuar drejt kërkesat, ankesat apo kundërshtimet.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)  
Rr. "Ilir Konushevc" nr. 8  
10 000 Prishtinë,  
Kosovë  
Tel: ++381 38 500 400 ext 0  
Fax-i: ++ 381 38 248 076  
Posta elektronike: info@pak-ks.org